

Statistikat e kulturës*

Tremujori IV –2020

Tiranë, më 29 Janar 2021: INSTAT publikon informacion për institucionet e artit dhe kulturës, të trashëgimisë kulturore dhe bibliotekës kombëtare.

Institucione të artit dhe kulturës

Gjatë tremujorit të katërt 2020, janë organizuar gjithsej 80 shfaqje dhe premiera të hapura, 7 shfaqje në Teatrin Kombëtar Popullor, 32 shfaqje në Teatrin Kombëtar Eksperimental, 20 shfaqje në Teatrin Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, 16 shfaqje në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe 5 shfaqje në Cirkun Kombëtar.

Gjatë vitit 2020, janë organizuar gjithsej 328 shfaqje dhe premiera në institucionet qendrore të artit. Krahasuar me vitin e kaluar, ky numër është shumë i ulët për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Megjithatë, institucionet e artit kanë vijuar veprimtarinë me shfaqje dhe premiera online, të publikuara në rrjete sociale.

Tab.1 Numri i shfaqjeve dhe premierave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/premiera	Viti 2019	Viti 2020	Tr.4-2019	Tr.4-2020
Teatri Kombëtar Popullor	157	63	51	7
Teatri Kombëtar Eksperimental	444	135	142	32
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	161	45	68	20
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	236	65	89	16
Cirku Kombëtar	126	20	33	5
Shfaqje kulturore/premiera gjithsej	1.124	328	383	80

Në tremujorin e katërt 2020, numri i spektatorëve gjithsej në aktivitetet kulturore është 5.457 spektatorë. Pjesëmarrja më e lartë e spektatorëve u evidentua në Teatrin Kombëtar Eksperimental (40,2 %) dhe në Cirkun Kombëtar (30,1 %).

Në institucionet qendrore të artit, gjatë vitit 2020, morën pjesë në aktivitetet kulturore 38.332 spektatorë.

* Shikoni Metodologjinë, fq. 4

Tab.2 Numri i spektatorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve	Viti 2019	Viti 2020	Tr.4-2019	Tr.4-2020
Teatri Kombëtar Popullor	34.790	5.252	8.470	0
Teatri Kombëtar Eksperimental	64.684	16.044	20.421	2.194
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	70.647	7.476	26.567	486
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	31.795	6.274	11.219	1.133
Cirku Kombëtar	21.698	3.286	4.800	1.644
Numri i spektatorëve gjithsej	223.614	38.332	71.477	5.457

Trashëgimi kulturore

Numri i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë kulturore, në tremujorin e katërt 2020, është 34.993 vizitorë, 15,5 % e të cilëve janë të huaj. Gjatë këtij tremujori, vizitorët vendas nuk kanë patur dallime të dukshme në frekuentim të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Ndërkohë, vizitorët e huaj kanë frekuentuar më shumë Kalatë dhe Monumentet.

Gjatë vitit 2020, numri i vizitorëve në muze, kala dhe parqe arkeologjike është 190.467 vizitorë, 16,8 % e të cilëve janë të huaj.


Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Viti 2019	Viti 2020	Tr.4-2019	Tr.4-2020
Muze	317.826	49.288	59.020	11.372
Kala e Monumente të tjera	322.395	62.627	44.002	12.073
Parqe Arkeologjike	424.860	78.552	47.612	11.548
Vizitorë gjithsej	1.065.081	190.467	150.634	34.993

Tab.4 Vizitorë vendas dhe të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Viti 2019		Viti 2020		Tr.4-2019		Tr.4-2020	
	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas
Muze	176.497	141.329	9.963	39.325	27.688	31.332	2.030	9.342
Kala e Monumente të tjera	180.462	141.933	13.757	48.870	22.275	21.727	2.405	9.668
Parqe Arkeologjike	228.391	196.469	8.234	70.318	24.146	23.466	975	10.573
Vizitorë gjithsej	585.350	479.731	31.954	158.513	74.109	76.525	5.410	29.583

Fig.1 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Biblioteka Kombëtare

Në tremujorin e katërt 2020, numri i shërbimeve të njësive bibliotekare është 2.856 dhe numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare është 2.733 persona. Gjatë këtij tremujori, janë afishuar 799 tituj të rinj dhe 3.477 ekzemplarë të rinj.

Gjatë vitit 2020, në Bibliotekën Kombëtare, numri i njësive bibliotekare është 20.306 dhe numri i frekuentuesve është 30.002 persona. Gjatë këtij viti, janë afishuar në total 2.537 tituj të rinj dhe 11.022 ekzemplarë të rinj.

Tab.5 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare

Treguesit	Viti 2019	Viti 2020	Tr.4-2019	Tr.4-2020
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	99.741	20.306	25.000	2.856
Frekuentimi	132.462	30.002	32.332	2.733
Veprimtari Kulturore dhe Shkencore	149	95	62	19
Numri i hyrjeve të reja:				
Numri i titujve të rinj	4.075	2.537	1.180	799
Numri i ekzemplarëve të rinj	14.933	11.022	4.185	3.477

Metodologjia

*Krahasimi i tremujorit të katërt 2020 me tremujorin e katërt të vitit të kaluar nuk është i mundur, pasi në ndryshim nga i njëjti tremujor i vitit të kaluar, shfaqjet kulturore të organizuara në institucionet e artit dhe kulturës janë pezulluar dhe vizitat në sitet e trashëgimisë kulturore janë lejuar duke zbatuar protokollet e sigurisë anti-Covid.

Në zbatim të Urdhërit Nr.132 datë 08.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, të Urdhërit të Ministrisë së Kulturës Nr.141 datë 11.03.2020 si edhe në vijim të masave të marra nga Qeveria (Vendim Nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”), janë pezulluar aktivitetet në institucionet kulturore qendrore.

Në zbatim të Urdhërit Nr. 351, datë 29.05.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID 19”, u lejuan me kufizime përkatëse vizitat në muze, parqe dhe kala, por jo rifillimi i aktivitetit për Artin.

Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore, të cilat janë në varësi të Ministrisë së Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirku Kombëtar.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

MUZE	KALA E MONUMENTE TË TJERË	PARK ARKEOLOGJIK
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apoloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalmos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë		Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

Përkufizime

Trashëgimi kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçarur brezave në të ardhmen, si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

Frekuentimi llogatitet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.

Materiale bibliotekare përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.

Tituj të rinj përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyjnë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.

Ekzemplarë të rinj përfshijnë numrin e njësive bibliotekare për çdo titull të ri.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës, me periodicitet tremujor.